

EBG shpk

Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022

1. Informacion i pergjithshem

Organizimi dhe aktiviteti

Shoqeria "EBG" shpk eshte themeluar si Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 07.09.2011 dhe eshte rregjistruar ne QKR Tirane me date 21.09.2011. Ortaku i vetem i Shoqerise eshte Z. Erion Gina. Nga data 06 Mars 2023, perfaqesues ligjor i Shoqerise eshte Gazmend Elbasani. Veprimtaria e shoqerise "EBG" shpk rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" si dhe nga statuti dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Shoqeria ka si objekt aktiviteti kryesor tregtimin e mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, etj. me shumice e pakice dhe hapjen e bareve, lokaleve, restoranteve, hoteleve, qendrave te pushimit, resorteve, etj. Shoqeria kryen aktivitetin e saj ne ambiente qe jane te mara me qira prej saj. Aktivitetet e qendrueshme prane te saj perbehen nga mjete transporti, pajisje informatike, dhe inventar ekonomik.

2. Përmbledhje e politikave të përgjithshme kontabel

2.1 Bazat e përgatitjes

a- Baza e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqerisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Pasqyrat Financiare janë përgatitur mbi parimin e kostos historike. Kjo politika është aplikuar në mënyrë konstante në përjashtim të rasteve kur është specifikuar ndryshe.

Pasqyrat Financiare të funditit janë paraqitur në formatin e paraqitur në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në fuqi (SKK 2) i përmirësuar.

Sipas parimeve të kontabilitetit në Shqipëri deklarimet financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Përgatitja e pasqyrave Financiare në përputhje me kërkesat e SKK, kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kontabile të rëndësishme. Kjo gjatë kërkon që menaxhimi i Shoqerisë të japë gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabile të saj. Fushat të cilat kërkojnë një shkallë të lartë ose komplekse të gjyqimit ose ato për të cilat vlerësimet apo supozimet janë të rëndësishme për hartimin e pasqyrave financiare paraqiten në shënime.

Periudha kontabel e përgatitjes së pasqyrave financiare është 1 Janar 2022 deri me 31 Dhjetor 2022.

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabel si dhe të ardhurat përkatëse.

Shpenzimet e kryera gjatë një periudhë raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njesise ekonomike raportuese, regjistrohen si shpenzime përkrah të periudhës kur merren përfitimet.

Mbajtja e kontabilitetit, i cili përfshin si regjistrimet kontabel dhe sistemin e tij, mbahen në mënyrë të kompjuterizuar, me anë të një programi të kontabilitetit.

2. Politikat kryesore kontabile (vazhdim)

Deklarimet financiare jane shprehur ne Leke, e cila eshte monedha shqiptare.

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur deklarimet financiare jane paraqitur sa me poshte:

2.2 Instrumentat financiare

Kompania ka vetem instrumenta financiare jo derivative, perfshire dhe kerkesa nga kliente dhe kerkesa te tjera, mjete likuide dhe te ngjashme me to, huamarrje dhe huadhenie, furnitore dhe te tjera detyrime.

Instrumentat financiare jo-derivative njihen, fillimisht, me vleren e drejte plus, çdo kosto te drejtperdrejte transaksioni te lidhura me to, pervec atyre te pershkruara me poshte. Ne vazhdim te njohjes fillestare instrumentat financiare vleresohen si me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese kompania eshte pale ne kushtet e kontrates. Aktivet financiare nuk njihen nese te drejtat e Kompanise mbi rrejdhat e ardhshme te parase te gjeneruara nga aktivi financiar kane mbaruar ose nese kompania i transferon aktivite financiare nje pale te trete pa mbajtur te drejtat e kontrollit ose ne thelb te gjitha rreziqet dhe perfitimet nga aktivi. Blerja dhe shitja normale e aktiveve financiare kontabilizohet ne daten e shitblerjes psh. daten ne te cilen kompania vendos vete te bleje apo te shese aktivet. Detyrimet financiare nuk njihen me nese detyrimet e Kompanise e specifikuara ne kontrate mbarojne afatin ose shlyen ose anulohen.

Mjetet Monetare

Zeri para ne dore dhe te ngjashme perfshin parate ne dore, depozita rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra shume likuide me afat maturimi tremujor ose me pak.

Kerkesa per t'u arketuar

Kerkesat per t'u arketuar afatshkurtera jane paraqitur ne bilanc me kosto te amortizuar, pra me vleren e koston se tyre minus provizionet e krijuara per renie ne vlere. Provizione te lejuara mund te llogariten, per shumat e vleresuara si te rikuperueshme, ne fitim humbje kur ekziston nje evidence objektive qe keto kerkesa jane zhvleresuar me pare.

Detyrime te pagueshme

Detyrimet per tu paguar dhe te tjera detyrime paraqiten me vleren e drejte te tyre dhe me pas maten me vleren e tyre te amortizueshme.

Huate bankare dhe te tjera

Ne vazhdim te njohjes fillestare, huate bankare dhe te tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njohur çdo diference midis koston dhe vleres se rikuperueshme ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes ne baze te nje interesi efektiv.

2. Politikat kryesore kontabile (vazhdim)

Te tjera

Te tjera instrumenta financiare jo-derivative maten me kosto te amortizueshme duke perdorur metoden e interes efektiv, minus cdo humbje nga zhvleresimi.

Kontabilizimi i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare sqarohet ne piken 2.8.

Aktivet financiare klasifikohen si detyrime afatshkurtra pervec rasteve kur kompania ka te drejte te pakushtezuar te ndryshoje marreveshjen e huase per te pakten 12 muaj pas dates se bilancit.

2.3 Inventaret

Inventaret maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare te tyre Shoqeria vlereson inventarin me vleren me te ulet midis koston dhe vleres neto te realizueshme. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësia ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Inventaret i nenshtrohen testit te zhvleresimit ne daten embylljes se bilancit. Shuma e Zhvleresimit njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ateherë kur ka faktore te ojektive qe tregojne qe inventaret jane zhvleresuar.

Metoda e vleresimit eshte kosto mesatare e ponderuar.

2.4 Aktivet Afatgjata Materiale

Ne bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Aktivet Afatgjata Materiale jane vleresuar me koston e blerjes dhe kosto te tjera te drejtperdrejta qe lidhen me sjelljen e aktivitetit ne kushtet e nevojshme per funksionimin e tij.

Metoda per llogaritjen e amortizimit per ndertesat dhe instalimet teknike eshte metoda lineare e cila merr ne konsiderate jeten e dobishme ekonomike, ndersa amortizimi per AAM te tjera llogaritet mbi bazen metodes zbritese si dhe duke marre ne konsiderate daten e venies ne perdorim te tyre.

Me date 31 Dhjetor 2022 norma e amortizimit e perdorur nga shoqëria eshte 10%.

Toka dhe Ndertimet ne Proces, si dhe parapagimet furnitoreve nuk amortizohen.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashte perdorimit percaktohen nga krahasimi i perfitimeve me vleren e tyre kontabel. Keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

2.5 Aktivet Afatgjata Jo-Materiale

Per vitin 2022 shoqeria nuk zoteron Aktive Afatgjata Jo Materiale. AAJM njihet fillimisht me koston qe perbehet nga çmimi i blerjes dhe kosto te tjera qe lidhen drejtperdrejt me blerjen.

AAJM paraqitet ne bilanc me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvleresimi

2.6 Kuotat e kapitalit

Kuotat e thjeshta njihen si kapital. Kuota njihet me vleren nominale.

2. Politikat kryesore kontabile (vazhdim)

2.7 Zhvleresimi i aktiveve jo financiare

Vlerat kontabile te aktiveve jofinanciare te Kompanise, pervec inventareve dhe tatimeve te shtyra rishikohen ne cdo date raportimi per te pare nese ka ndonje tregues per zhvleresim. Nese ekziston ndonje tregues i tille ateherë vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga zhvleresimi njihet nese vlera kontabile e nje aktivi eshte me e madhe se vlera e rikuperueshme e tij. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e nje aktivi eshte me e madhja mes vleres se tij ne perdorim dhe vleres se drejte minus kostot e shitjes. Ne matjen e vleres ne perdorim, flukset e pritshme te parase skontohen ne vleren e aktuale duke perdorur normene skontimit perpara takses qe paraqet vleresimin e tregut per vleren ne kohe te parase dhe riskun specifik te aktivit.

Per humbjet nga zhvleresimi te njohura ne periudhat e meparshme vleresohet ne cdo date raportimi nese ka ndonje tregues sipas te cilit humbja eshte ulur ose nuk ekziston me. Njehumbje nga zhvleresimi anulohet nese kane ndodhur ndryshimet ne vleresimet e bera perpercacktimin e vleres se rekuperueshme. Nje humbje nga zhvleresimi anulohet deri ne ate mase qe vlera kontabel e aktiveve te mos kaloje vleren kontabel te aktiveve, minus amortizimin, qe dote ishte percaktuar nese zhvleresimi nuk do te kishte ndodhur.

2.8 Zhvleresimi i aktiveve financiare

Nje aktiv financiar zhvleresohet nese ekzistojne tregues sipas te cileve nje ose disa ngjarje kane pasur nje ndikim negativ ne vleresimin e fluksesve te ardhshme te parase prej atij aktivi.

Humbja nga zhvleresimi ne rastin e nje aktivi financiar te vleresuar me kosto te amortizuar llogaritet si difference midis vleres kontabel (neto) dhe Vleres aktuale te flukseve te pritshme te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktive financiare te nje rendesie te vecante testohen per zhvleresim ne menyre te vecante. Pjesa tjeter e aktiveve vleresohen se bashku, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Humbja nga zhvleresimi mund te anulohet nese ajo mund te lidhet objektivist me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes se zhvleresimit. Per aktivet financiare te vlersuara ne kosto te amortizuara anulimi i zhvleresimit njihet ne fitim humbje.

2.9 Njohja e te ardhurave

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm vleren e drejte të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjate aktivitetit te zakonshem te Kompanise.

Te ardhurat perfshijne shumat neto pa perfshire shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, te cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto.

Ne lidhje me shitjen e mallrave, te ardhurat jane njohur kur ndryshimi i pronesise se bashku me riskun qe vjen nga ky ndryshim, jane transferuar tek blesesi.

2. Politikat kryesore kontabile (vazhdim)

2.10 Shpenzimet

Pagesat per qerate

Pagesat e kryera si qera e zakonshme njihen ne shpenzime te periudhes ne baze lineare duke u mbeshtetur ne kushtet e qerases.

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara. Shpenzimet per kerkime e zhvillime pergjithesisht jane ngarkuar ne llogarine e shpenzimeve ne periudhen se ciles i perkasin.

2.11 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare permbledhin te ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huate, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet a aktivave financiare. Gjithe kostot e huamarrjeve njihen ne humbje fitime mbi bazen e perdorimit te metodes se interesit efektiv.

2.12 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre

Shpenzimi (e ardhura) tatimore permban shpenzimin tatimor aktual (te ardhuren tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor te shtyre (te ardhuren tatimore te shtyre). Shpenzimet qe lidhen me tatimin mbi te ardhurat paraqitet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec rastevekur ai lidhet me zerat e kapitalit dhe ne kete rast paraqitet direkt ne kapital.

Shpenzimi tatimor aktual eshte shuma e tatimit qe pritet te paguhet bazuar ne te ardhurat e vitit ushtrimor, shkallen tatimore qe zbatohet ne ditën e raportimit si dhe cdo korrjigim te detyrimeve tatimore te viteve paraardhese. Tatimi i shtyre njihet duke perdorur metoden e pasivit të bilancit, duke marre si diference te perkohshme diferencat midis bazës tatimore të një aktivi ose pasivi dhe vlerës së tij kontabël neto në bilanc. Tatimi i shtyre llogaritet duke u bazuar ne shkallen tatimore, te percaktuar nga ligjet qe jane ne fuqi, qe pritet te jete e zbatueshme ne momentin kur diferenca e perkohshme do te zhduket.

Kompania njej aktivin për tatim të shtyrë vetëm për aq sa është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme jenë të disponueshme kundrejt të cilave të mund të përdoret aktivi tatimor i shtyrë. Vlera kontabël e një aktivi tatimor të shtyrë duhet të rishikohet në çdo datë të bilancit. Një njësi ekonomike do të zvogëlojë vlerën kontabël të një aktivi tatimor të shtyrë për aq sa nuk ka më mundësi që fitim i tatueshëm i mjaftueshëm të jetë i disponueshëm për të lejuar përfitimin e përdorimit të një pjese ose i të gjithë atij aktivi tatimor të shtyrë. Çdo zvogëlim i tillë do të rimerret deri në masën që bëhet mundur disponimi i fitimit të tatueshëm të mjaftueshëm.

2. Politikat kryesore kontabile (vazhdim)**2.13 Transaksionet me monedhat e huaja****(a) Monedha e perdorur dhe raportuese**

Zerat e perfshire ne pasqyren financiare te seciles prej njesive ekonomike te grupit maten ne monedhen baze te mjedisit ekonomik ne te cilen njesia ekonomike vepron (monedha ne perdorim). Pasqyrat e financiare raportohen ne LEKE shqiptar (ALL), e cila eshte monedha e perdorur dhe raportuese e Kompanise.

(b) Transaksionet dhe Gjendjet

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve ne monedhe te huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-vitit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit me te rendesishme jane :

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
1 EUR	114.23	120.76
1 USD	107.05	106.98

3. Manaxhimi i rrezikut financiar

Manaxhimi i rrezikut financiar eshte nje element i rendesishem ne aktivitetin e Shoqerise. Rreziqet kryesore me te cilat perballet Shoqeria jane ato qe lidhen me rrezikun e tregut i cili perfshin rrezikun e çmimit, te normes se interesit dhe te kursit te kembimit, rrezikun e kredise dhe rrezikun e likuiditetit.

3.1 Politikat dhe procedurat per manaxhimin e rrezikut

Politikat e Shoqerise per manaxhimin e rrezikut kane per qellim te identifikojne, analizojne, menaxhojne rreziqet me te cilat perballet Shoqeria, te percaktojne kufijte e rrezikut, te vendosin kontrole per te mbikqyrur riskun ne kufijte e percaktuadhe te sigurojne permes monitorimit qe ekspozimi ndaj rreziqeve te qendroje brenda ketyre kufijve. Politikat dhe procedurat per manaxhimin e riskut rishikohen rregullisht per te pasqyruar ndryshimet ne kushtet e tregut, produktet dhe sherbimet e ofruara dhe paraqitjen e praktikave te perditesuara.

Drejtimi i Shoqerise ne bashkepunim te ngushte me mbikqyrjen e strukturave te manaxhimit te riskut ka pergjegjesi te plote per mbikqyrjen e kuadrit te manaxhimit te riskut, mbikqyrjen e manaxhimit te rreziqeve kryesor dhe rishikimin e politikave dhe procedurave te tij te manaxhimit te rrezikut sikurse miratimin e transaksioneve te rendesishme dhe me shuma te konsiderueshme.

Si faktoret e brendshem ashtu edhe atote jashtem jane identifikuar dhe manaxhuar permesstruktures organizative te Shoqerise,dhe veçanerisht nga strukturat e manaxhimit te riskut ne nivel grupi.

3.1.1 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut eshte rreziku i humbjes si rezultat i ndryshimeve ne çmimet e tregut, kurset e kembimit, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit. Rreziku i tregut vjen nga ekspozimi i kompanise ndaj normave te interest, kurseve te kembimit dhe elementeve te tjere te cilet jane ne ndikim te drejtperdrejte te ndryshimeve te pergjithshme dhe specifike te tregut dhe ndryshimeve ne nivelin e qendrueshmerise se çmimeve netreg

Objektivi i manaxhimit te riskut te tregut eshte te menaxhoje dhe kontrolloje ekspozimin e rrezikut te tregut brenda parametrave te pranueshem.

EBG shpk**Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022****3. Manaxhimi I rrezikut financiar (vazhdim)****3.1.2 Rreziku i normes se interesit**

Rreziku i normes se interesit eshte rreziku qe ndryshimi ne normat e interesit mund te shkaktoje luhatje ne te ardhurat e Shoqerise ose ne vleren e portofolit te investimeve.

Te ardhurat e Shoqerise dhe flukset monetare operative jane pothuajse te pavarura nga ndryshimet ne normat e interesit te tregut pasi Shoqeria nuk ka aktive financiare te cilat mbartin interes. Ndryshimet ne normat e interesit ndikojne kryesisht huamarrjet dhe huadheniet me normainterese te ndryshueshme, duke ndryshuar flukset e ardhshme monetare. Drejtimi i Shoqerise nuk ka nje politike zyrtare te percaktimit te shumave te dhena ose te marra hua me norma interese fikse ose te ndryshueshme. Megjithate, ne kohen e huamarrjeve te reja drejtimi perdor gjykimin e tij per te vendosur nese nje norme interese fikse ose e ndryshueshme do te ishte me e favorshme per Shoqerine gjate periudhes deri ne maturim.

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Aktive financiare		
<i>Që nuk mbartin interes</i>		
Te drejta dhe te tjera te arketueshme	90,129,824	35,167,073
Huadhenie te tjera	2,000,000	2,000,000
Mjete Monetare	1,561,169	367,978
<i>Me norma interese fikse</i>	-	-
Total aktive financiare	93,690,993	37,535,051
Detyrimet financiare		
<i>Që nuk mbartin interes</i>		
Detyrime te pagueshme	139,139,160	112,675,166
Te tjera te pagueshme	80,976,954	80,256,954
	220,116,114	192,932,120
<i>Me norma interese të ndryshueshme</i>		
Detyrime ndaj institucioneve te kredise	12,106,157	14,383,131
	12,106,157	14,383,131
	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Te drejta dhe te tjera te arketueshme	92,129,824	37,167,073
Mjete Monetare	1,561,169	367,978

EBG shpk**Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022****3. Manaxhimi I rrezikut financiar (vazhdim)****3.1.3 Rreziku i kursit te kembimit**

Shoqeria ka aktive dhe detyrime te shprehura ne USD dhe ne Euro. Rreziku i kursit te kembimit lind kur aktivet aktuale ose te parashikuara ne nje monedhe te huaj jane me te medha ose me te vogla se detyrimet ne ate monedhe.

	Euro	Lek	Total
31 Dhjetor 2022			
Te drejta dhe te tjera te arketueshme	5,576,252	84,553,572	90,129,824
Mjete Monetare	771,130	790,039	1,561,169
Huadhenie te tjera	-	2,000,000	2,000,000
	6,347,382	87,343,611	93,690,993

	Euro	Lek	Total
31 Dhjetor 2022			
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	11,994,039	112,118	12,106,157
Hua te tjera te pagueshme	-	31,976,954	31,976,954
Detyrime te pagueshme	6,978,016	132,161,144	139,139,160
	18,972,056	164,250,215	183,222,271
Pozicioni Neto	(12,624,674)	(76,906,604)	(89,531,278)

	Euro	Lek	Total
31 Dhjetor 2021			
Te drejta dhe te tjera te arketueshme	10,377,134	24,789,940	35,167,073
Mjete Monetare	100,822.62	267,161	367,984
Huadhenie te tjera	-	2,000,000	2,000,000
	10,477,956	27,057,101	37,535,057

	Euro	Lek	Total
31 Dhjetor 2021			
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	12,076,647	2,306,483.73	14,383,131
Hua te tjera te pagueshme	-	31,256,954	31,256,954
Detyrime te pagueshme	4,075,553	108,599,613	112,675,166
	16,152,201	142,163,050	158,315,251
Pozicioni Neto	(5,674,244)	(115,105,949)	(120,780,194)

Analiza e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Nje forcim i arsyeshem i euros kundrejt lekut shqiptar me 31 dhjetor 2022, do te kishte ndikuar ne matjen e instrumentave financiare te shpresur ne monedhe te huaj si dhe ne fitimin ose humbjen ne shumat e paraqitura me poshte:

	Vleresim	Zhvleresim
10% Euro	(1,262,467)	1,262,467

10% 

3.1.4 Rreziku i kredise

Rreziku i kredise eshte rreziku qe nje pale ne nje instrument financiar te shkaktoje nje humbje financiare ndaj pales tjeter duke deshtuar ne shlyerjen e detyrimit dhe vjen kryesisht si pasoje e llogarive te arketueshme te Shoqerise nga klientet e saj.

Ekspozimi i Shoqerise ndaj rrezikut te kredise ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale te çdo klienti. Shoqeria ka njohur nje zhvleresim per llogarite e arketueshme qe pasqyron vleresimin e saj per humbjet e pritshme ne lidhje me llogarite e arketueshme nga klientet dhe te tjera te arketueshme. Zhvleresimi eshte llogaritur mbi bazen e analizes individuale per klientet.

3.1.5 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit percaktohet si rreziku qe Shoqeria te ndeshe veshtiresi ne shlyerjen e detyrimeve te saj financiare. Perqasja e Shoqerise per te manaxhuar likuiditetin eshte qe te siguroje aq sa eshte e mundur se do te kete gjithmone likuiditet te mjaftueshem per te shlyer detyrimet e saj kur ato kerkohen si ne kushte normale dhe jonormale pa shkaktuar humbje te papranueshme ose te rrezikoje demtimin e emrit te Shoqerise.

Shoqeria sigurohet vazhdimisht se ka mjete te mjaftueshme monetare per te paguar shpenzimet e pritshme operationale, duke perfshire sherbimin e detyrimeve financiare. Kjo perjashton ndikimin e mundshem te rrethanave ekstreme qe nuk mund te parashikohen si psh. fatkeqesite natyrore.

	Afatshkurta		Afatgjata		Totali
	1 deri 12 muaj	1 deri 2 vjet	2 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	
Më 31 Dhjetor 2022					
Te drejta dhe te tjera te arketueshme	90,129,824				90,129,824
Mjete Monetare	1,561,169				1,561,169
Huadhenie te tjera			2,000,000		2,000,000
	91,690,993	-	2,000,000	-	93,690,993
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	12,106,157				12,106,157
Hua te tjera te pagueshme		31,976,954			31,976,954
Detyrime te pagueshme	139,139,160				139,139,160
	151,245,317	31,976,954	-	-	183,222,271
Risku i likuiditetit ne 31 Dhjetor 2022	(59,554,324)	(31,976,954)	2,000,000	-	(89,531,278)

	Afatshkurta		Afatgjata		Totali
	1 deri 12 muaj	1 deri 2 vjet	2 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	
Më 31 Dhjetor 2021					
Te drejta dhe te tjera te arketueshme	35,167,073				35,167,073
Mjete Monetare	367,978				367,978
Huadhenie te tjera			2,000,000	-	2,000,000
	35,535,051	-	2,000,000	-	37,535,051
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	14,383,131				14,383,131
Hua te tjera te pagueshme	31,256,954	-			31,256,954
Detyrime te pagueshme	112,675,166				112,675,166
	158,315,251	-	-	-	158,315,251
Risku i likuiditetit ne 31 Dhjetor 2021	(122,780,200)	-	2,000,000	-	(120,780,200)

3.2 Manaxhimi i kapitalit

Objektiva e Shoqerise ne lidhje me manaxhimin e kapitalit eshte ruajtja e aftesise e saj per vijimesi te biznesit, ne menyre qe te mundesojekthimin e perfitimeve te pritura ngaaksionaret,e perfitimeve per grupe te tjera te interesit dhe per te mbajtur nje strukture optimale te kapitalit e cila reduktonr koston e tij. Totali i kapitalit nen administrim eshte i barabarte me kapitalin siç tregohet ne bilancin kontabel plus borxhin neto. Borxhi neto llogaritet si huamarrjet totale siç tregohet ne bilancin kontabel minus mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre.

Shoqeria eshte financuar me kapitalin minimal dhe kryesisht me huamarrje te brendshme dhe detyrime ndaj paleve te lidhura. Shoqeria meme ka konfirmuar se eshte ne politiken e saj aktuale te sigurohet se Shoqeria eshte ne gjendje te shlyeje borxhet e saj dhe angazhimet e saj per shpenzimet ne lidhje me investimet kapitale kur ato kerkohet te paguhen. Shoqeria meme ka konfirmuar gjithashtu, se do te mbeshtese per tu siguruar se Shoqeria do te kene fondet e nevojshme per te shlyer detyrimet e tyre kur ato kerkohet te paguhen. Shoqeria nuk ka kerkesa te vendosura nga jashte ne lidhje me kapitalin.

4. Gjykimet dhe vleresimet kryesore kontabel

Drejtimi i Shoqerise ka perdorur gjykimin e tij ne lidhje me nje sere vleresimesh e supozimesh ne lidhje me raportimin e aktiveve dhe detyrimeve dhe shpjegimin e aktiveve dhe detyrimeve te kushtezuara ne pergatitjen e pasqyrave financiare. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime.

5. Mjete monetare

Likuiditetet jane paraqitur ne bilanc me gjendjen e llogarive bankare ne fund te periudhes me date 31 Dhjetor 2022, te cilat jane te njejta me ekstraktin e fundit te bankave per kete periudhe.

	<i>31 Dhjetor 2022</i>	<i>31 Dhjetor 2021</i>
Vlera monetare bankare, në lekë	1,245,676	241,643
Vlera monetare ne arke, në lekë	315,494	126,335
Vlera monetare te ngurtesuara	-	-
Totali	1,561,169	367,978



EBG shpk**Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022****6. Te drejta te arketueshme**

Te drejta te arketueshme paraqiten si më poshtë.

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Te drejta te arketueshme nga shfrytezimi	90,129,824	35,167,073
Te drejta te tjera te arketueshme	-	-
Totali	90,129,824	35,167,073

6.1 Te drejta te arketueshme nga shfrytëzimi ne vlere 90,129,824 leke perfaqeson detyrimet e Klienteve ndaj Shoqerise pas dates 31 Dhjetor 2022 (2021: 35,167,073 leke).

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Kliente per mallra , produkte e sherbime	90,129,824	35,167,073
Totali	90,129,824	35,167,073

7. Inventari

Inventari me 31 Dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë.

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Materiale te para	1,979,519	19,035,864
Mallra	14,811,418	23,277,001
Inventar i imet	10,995,104	10,995,104
Totali	27,786,042	53,307,969

8. Parapagimet dhe Shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra me 31 Dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë.

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Parapagime te dhena	1,421,057	395,327
Parapagime doganore	28,226	23,356
Total	1,449,283	418,683

9. Huadhenie te tjera

Ne date 27.12.2018 midis palëve *EBG shpk* ne statusin e huadhënësit dhe *Jora shpk* ne statusin e huamarrësit eshte lidhur nje kontrate huadhënie ne vlerën 2,000,000 leke. Nuk ka ndryshime në gjëndjen e kësaj huaje gjatë periudhës raportuese.

EBG shpk**Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022****10. Aktive afatgjata materiale**

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive materiale afatgjata sipas SKK 5.

Kosto Historike	Ndertese	Instalime teknike	Mjete Transporti	Pajisje zyre, mobilje	Pajisje Informative	Te tjera	Totali
Gjendje 31.12.2021	103,394,273	20,064,648	2,857,980	40,126,025	8,222,875	8,117,363	182,783,164
Shtesa			3,495,617				3,495,617
Pakesime (-)		(244,545)	(1,479,217)	(11,768,262)	(1,189,237)	(276,856)	(14,958,117)
Gjendje 31.12.2022	103,394,273	19,820,103	4,874,380	28,357,763	7,033,638	7,840,506	171,320,664
Amortizimi							
Gjendje 31.12.2021	10,113,868	4,150,038	858,711	19,739,496	3,962,288	4,606,465	43,430,866
Shtesa llogaritur	9,371,624	218,698	401,567	3,274,853	359,341	501,530	14,127,612
Pakesime		(187,462)		(3,955,576)	(386,083)	(26,701)	(4,555,823)
Gjendje 31.12.2022	19,485,492	4,181,274	1,260,278	19,058,773	3,935,545	5,081,294	53,002,655
Vlera neto 31.12.2021	93,280,405	15,914,610	1,999,269	20,386,529	4,260,587	3,510,898	139,352,298
Vlera neto 31.12.2022	83,908,782	15,638,830	3,614,102	9,298,990	3,098,093	2,759,213	118,318,009

Paraqitja në pasqyra financiare bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi i akumuluar. Të gjitha aktivet afatgjata materiale janë përfituar nga blerjet. Inventari i aktiveve afatgjatë materiale është vlerësuar me koston e marrjes së tyre. Asnjë nga aktivet e njësisë nuk është vendosur peng ndaj palëve të treta. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar të ardhura nga shitja e aktiveve materiale në shumën 2,924,583 Lekë dhe **amortizim 14,127,612 Lek**

EBG shpk**Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022****11. Detyrime ndaj institucioneve të kredisë**

Ne kete ze paraqiten detyrimet ndaj institucioneve bankare ne lidhje me me date 31 Dhjetor 2022:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Karta e Kreditit- BKT	112,301	357,030
Overdraft- RZB EURO	11,994,039	12,076,647
Overdraft- Tirana Bank EURO	(183)	1,086
Hua nga RZB per pagat e luftes	-	1,948,368
Totali	12,106,157	14,383,131

12. Detyrime te pagueshme

Detyrimet e pagueshme me 31 Dhjetor 2022 paraqiten si me poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Te pagueshme ndaj furnitoreve	84,787,953	86,231,706
Te pagueshme ndaj Punonjesve	8,475,722	4,954,048
Detyrime Tatimore	11,096,879	8,305,404
Detyrime te tjera	34,778,606	13,184,008
Totali	139,139,160	112,675,166

12.1 Te pagueshme ndaj Punonjesve

Te pagueshme ndaj punonjesve me 31 Dhjetor 2022 paraqiten si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Paga dhe shpërblime	5,454,618	3,750,401
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3,021,104	1,203,647
Total	8,475,722	4,954,048

12.2 Detyrime Tatimore

Detyrime tatimore me 31 Dhjetor 2022 paraqiten si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Tatimi në burim	494,571	208,023
Tatimi mbi fitimin	3,710,165	5,990,843
TVSH	6,892,143	2,106,539
Total	11,096,879	8,305,404



EBG shpk**Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022****13. Huamarrje te tjera**

Huamarrje te tjera përfaqësojne huate afatshkurtera financimi pa interes të marrë nga individë te ndryshem te paraqitura si me poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Debitore te tjere ,kreditore te tjere	31,256,954	31,256,954
Hua ne lek	-	-
Hua ndaj Encore	720,000	
Total	31,976,954	31,256,954

13.1 Te tjera te pagueshme perfaqeson hua afatshkurtra te marra nga individë te ndryshem ne vleren 49,000,000 leke

14. Kapitallet e veta

jane detajuar sipas zerave:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Kapitali Aksioner/nenshkruar	100,000	100,000
Fitime e pashperndara	-	634,607
Fitime/Humbje te vitit financiar	8,922,054	22,564,144
Total	9,022,054	23,298,751

15. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Te ardhurat nga aktiviteti kryesor i njësisë ekonomike per periudhën raportuese paraqiten ne shumën 291,482,758 Lekë (2021: 178,598,524 Lekë).

Te ardhura nga aktiviteti kryesor	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Shitje e punimeve dhe e sherbimeve	171,831,375	68,508,467
Te ardhura nga Kontratat	5,950,000	1,006,375
Te Ardhura Nga Hoteli	8,090,698	7,663,965
Te Ardhura Nga Sherbimi Restorant	63,471,006	38,151,960
Te Ardhura Nga Sherbime Parku	-	645,167
Shitje mallrash	41,754,679	62,552,591
Qera	385,000	70,000
	291,482,758	178,598,524

Te ardhurat e tjera ne vleren 12,147,307 leke perfaqesojne te ardhura nga shitja e aktiveve afatgjate dhe te ardhura te tjera.

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Te ardh. nga shitja AQ	2,924,583	5,901,295
Të ardhura të tjera financiare	9,222,724	213,008
	12,147,307	6,114,304



EBG shpk**Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022****15.1 Rakordimi te ardhurave me sistemin Tatimor**

	31 Dhjetor 2022
Te ardhura totale sipas FDP te TVSH	309,882,733
Autongarkesa (Per efekt deklarimi)	(15,322,542)
Te ardhura per tu rakorduar	294,560,191
Te ardhura sipas kontabilitetit	304,183,780
<i><u>Diferenca</u></i>	<i><u>9,623,589</u></i>
Te ardhura nga interesi	
Te ardhura nga kursi i kembimit/azhornime	(553,708)
Te ardhura nga faljet e detyrimeve	(9,222,724)
Parapagime	152,843
Diferenca	0.00

16. Mallra, lende te para e sherbime

Zeri mallra, lende te para e sherbime per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022 perbehet si meposhte:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Blerje/Shpenzim Lende e Pare	69,551,653	339,759
Ndryshim Gjendje Lende e Pare	-	-
Ndrysh.gjend.mallra	25,521,926	(14,513,963)
Bl.energji,avull,uje	3,952,121	4,964,080
Blerje /shpenzime mallra, sherbimesh	13,522,327	35,436,966
Total	112,548,028	26,226,842

17. Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

Në pasqyrën më poshtë paraqiten shpenzimet e tjera operacionale.

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Shërbime nga të tretët	28,743,381	7,030,501
Trajtime të përgjithshme	(0)	1,185,776
Qira	19,776,475	21,095,263
Mirëmbajtje dhe riparime	404,694	1,106,844
Të tjera	502,887	6,683
Publicitet, reklama	(0)	568,788
Transferime, udhëtime, dieta	603,330	-
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	606,055	589,621
Shpenzime transporti	92,604	301,698
Shpenzime për shërbimet bankare	791,218	624,616
Tatime dhe taksa	354,965	404,792
Taksa, tarifa doganore	99,194	451,489
Shpenzime të tjera	36,422,926	27,922,930
Gjoha dhe demshperblime	1,740,765	841,931
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	5,377,330	2,625,000
Humbje nga këmbimet valutore	-	911,345
Vlera kontabel e aktive afatgjata te shitura	7,425,873	6,011,086
Total	102,941,696	71,678,363

EBG shpk**Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022****18. Shpenzime te Personelit**

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Pagat dhe shpërblimet e personelit	53,474,055	49,166,440
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	7,636,706	7,382,078
Total	61,110,761	56,548,518

Në datën e mbylljes së pasqyrave financiare detyrimi ndaj punonjësve është 5,454,618 Lekë.
Numri mesatar i punonjësve gjate vitit 2022 është 64 punonjes (per vitin 2021 ; 72.5)

19. Të ardhura dhe shpenzime financiare paraqiten si me poshtë:

Shpenzime financiare		
	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Shpenzime për interesa	808,876	791,796
	808,876	791,796
Të ardhura financiare		
	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Të ardhura nga interesat	-	-
Fitim nga këmbimet valutore	553,715	736,815
	553,715	736,815

20. Tatim Fitimi

Bazuar ne legjislicacionin Shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% per vitin 2022 Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit por te ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar per qellime tatimore konsiderohen vetedeklarime deri ne momentin qe autoritetet tatimore shqyrtojne deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe leshojne vleresimin final. Kuadrimi i normes efektive te tatim fitimit per periudhen per qellime tatimore është si me poshte:

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Fitimi para tatimit	12,646,808	28,942,493
Shpenzime te panjohura	2,600,230	10,465,466
Pritje perfaqesime tej limitit	4,464,778	2,068,651
Gjoha dhe dëmshpërblime	1,740,765	841,931
Shpenzime interesa	495,275	203,782
Vlera kontabel e aktiveve te shitura	2,883,839	-
Per zhvleresimin e AQ afatshkurtra	-	-
Shpenzime te panjohura	12,184,887	13,579,831
Baza e tatueshme	24,831,695	42,522,323
Humbje te mbartura		
Fitimi i tatueshem	24,831,695	42,522,323
Tatimi mbi fitimin 15%	3,724,754	6,378,348
Tatim mbi fitimin i parapaguar	-	
Tatim mbi fitimin i pagueshem	3,724,754	6,378,348

EBG shpk**Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022**

20.1 Shpenzime të pazbritshme

Shpenzimet e mëposhtëme janë përjashtuar nga rezultati tatimor në referencë të Ligjit Nr.8438 datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të ardhurat.

	<i>31 Dhjetor 202</i>	<i>31 Dhjetor 2021</i>
Shpenzime te panjohura	2,600,230	10,465,466
Shpenzime per pritje perfaqesime tej limitit	4,464,778	2,068,651
Gjoha dhe dëmshpërblime	1,740,765	841,931
Vlera kontabel e aktiveve te shitura	2,883,839	-
Per zhvleresimin e AQ afatshkurtra		-
Shpenzime interesa	495,275	203,782
Shpenzime te panjohura	12,184,887	13,579,830

21. Transaksionet me pale te lidhura

Ne 31 Dhjetor 2021 shoqeria ka hua afatshkurtra te pagueshme me palet e lidhura si më poshte:

	<i>31 Dhjetor 2022</i>	<i>31 Dhjetor 2021</i>
Hua te pagueshme	49,000,000	49,000,000
Total	49,000,000	49,000,000

22. Ngjarje pas datës se raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullime ose paraqitje të informacionit në pasqyrat financiare të Shoqerise.

